
Hap pas hapi

Ecje jo-kompetitive për integrim



Kisha Katolike Berat
Rruga Shetitoria, Lagjia 30 Vjetori

Associazione Piccola Famiglia Onlus



Famullia katolike
Sh.Luka

Projekt

Hap pas hapi



Përshkrimi i projektit

Eventi “Hap pas hapi” është një ecje jo-kompetitive nëpër rrugët e qytetit, drejtuar personave me aftësi të kufizuara dhe me probleme mendore, dhe edukatorëve të qendrave rezidenciale të territorit, e institucioneve shkollore dhe qytetërimit mbarë.

Kur

Eventi do të zhvillohet të shtunën 14 qershor nga ora 18.30 deri në orën 21.00.

Ku

Itenerari që do të përshkojmë fillon tek Hotel Palma, me një mikpritje në fillim për të gjithë pjesëmarrësit, me pjesmarrjen e autoriteteve lokale. Rrugëtimi do të zhvillohet në rrugët e qytetit dhe do të mbarojë në Qendrën Baritoren të Kishës Katolike në rrugën Shetitoria, Lagja “20 Vjetori”. Propozohet itenerari i mëposhtëm:

- Kryqëzimi midis Bulevardi Republika dhe Rrugën Antipatrea
- Bulevardi Republika
- Katedralia Ortodokse (pushim)
- Rruga Antipatrea (Bashkia) - Bulevardi Republika
- Rruga Sh.Luçia Filipini (Universiteti UFO)
- Shetitoria Osumi ----> Qendra Baritore Kisha Katolike

Instrumente të promovimit të vlerave

“Hap pas Hapi” propozohet si një event promovues i vlerave civile dhe morale me karakter laik. Promovon integrimin midis personave me aftësi të kufizuara e me probleme mendore me qytetërimin, me vëmendje të veçantë edhe ndaj realitetit rinor dhe të institucioneve të formimit e edukimit.

Mjetet:

- **pjesmarrja: personat me aftësi të kufizuara** së bashku me vullnetar nga territori.
- **shikueshmëri:** ecja nëpërmjet vendeve kryesore dhe karakteristike të qytetit. Shikueshmëria rritet nga pjesmarrja e mediave lokale dhe shumë e vlerësuar nga pjesmarrja e autoriteteve publike. Imazhet dhe lajmet e eventit do të shpërndahen më pas nga mjetet e komunikimit lokal dhe internacional (nëpërmjet web, thematic-channel, social-network, youtube edhe site të shoqatave italiane).
- **teritori:** Eventit promovon territorin, duke vlerësuar hapsirat qytetare. Qyteti i Beratit përjetohet si “vend i banueshëm” dhe “i mundshme” për të gjitha shtresat e qytetarëve, edhe për ata më të pafavorizuar. Nga kjo përfitojnë jo vetëm pjesmarrësit, por edhe territori, me më shumë dukshmëri dhe vlerat sociale.
- **festa:** do përfundojmë gjithçka me një festë (koktejl e muzikë-live) të financuar nga Kisha Katolike (me pjesmarrjen e enteve partner). Koktejli u ofrohet pjesmarrjesve të shetitjes, ndërsa në koncert me muzikë-live janë të ftuar të gjithë ata që dëshirojnë. Në festë do të jenë të ftuar grupet muzikore rinore dhe grupe popullore.

Pjesmarrjet:

Shpresojmë në pjesmarrjen e enteve mëposhtme:

- Qendra residenciale “Ne jemi si ju”
- Qendra “Lira”
- Qendra socio-edukative “Shen Asti”
- Bashkësia e krishterë e Kuçovës
- Bashkësia e krishterë e Uznovës
- Gjimnazet e vendit
- Policia

Mysafirët

Janë të ftuar mysafirët e mëposhtshëm, të cilëve do t'u jepet fjala për përshendetjet:

- Kryetari i bashkisë
- Udhëheqja e arsimit
- Udhëheqja e puneve sociale
- Koordinatorët e Qëndrave edukative dhe sociale të ftuara
- Famullitari i Kishës katolike të Beratit
- Drejtorët e shkollave të ftuara

Bashkpunimet

Ngjarja zhvillohet paralelisht me ngjarjen “Camminabile” e promovuar nga disa ente italiane me resonancë kombetare nëpërmjet rjeteve të mbështetjes të distancë (në veçanti ForumSaD Nazionale). Entet italianet mbështesin edhe ekonomikisht ngjarjen në Itali.

- Shoqata Onlus “La Piccola Famiglia” (Italia)
- Kooperativa Sociale “Montetauro” (Italia)

Gjatë darkës do të zhvillohet edhe një lidhje me “Camminabile” në Itali (Provinca e Rimitit), lidhja që do të ketë përhapje edhe në mjetet e komunikimit italianë9.